



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 67, datë 06.02.2020

**PËR
TRANSFERIMIN E GJYQTARES ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 44, pika 1, shkronja “b” dhe pika 2, shkronja “b”, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi shqyrtoi kërkesën e gjyqtares znj. {...} për kthimin në pozicion në sistemin gjyqësor pas përfundimit të periudhës së komandimit në një institucion brenda sistemit të drejtësisë, si dhe në zgjedhjen e bërë nga ajo për pozicionet e propozuara për t’u transferuar në kushtet e suprimimit të pozicionit të saj në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, në vijim të Vendimit të tij nr. 32, datë 23.01.2020, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Transferimin e gjyqtares znj. {...} pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit.
3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR